



INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS
Sektori i Hidrologjisës dhe Prognozave Hidrologjike

Data e parashikimit: 2023-06-10 12 UTC

Dt: 11/06/2023

Subjekti: Informacione hidrometeorologjike - Paralajmërim për vërshime/përmbytje

Njoftim nr. 07 /23

Situata Hidrometeorologjike
Aktivitet (reshje dhe vërshime)

Duke u bazuar në situatën e përgjithshme meteorologjike në vend dhe në përgjithësi në rajon e cila është jo stabile, duke u përcjellë me reshje të shiut, të cilat deri më tani kanë qenë të karakterit lokal me intensitet prej të ulët deri mesatarë e në disa zona deri në mesatarisht të lartë, kanë kontribuar që rrjedhat lumore ti mbajnë të qëndrueshme nivelet dhe prurjet e tyre, ndërsa disa prej tyre aktualisht ndodhën në kuotat e tyre mesatare deri afër maksimaleve. Këto reshje kanë ndikuar edhe në tejngopjen e tokave, sidomos nëpër viset e ulëta dhe përgjatë rrjedhave lumore. Situata e tillë me reshje, parashikohet të mbajë edhe gjatë ditëve në vijim, ku duke filluar nga nesër dt: 12/06/2023, pritet që të ketë reshje në intervale të ndryshme duke përfshi pjesën më të madhe të vendit, ndërsa në disa zona ato do të jenë më intensive të cilat mund të krijojnë vërshime të shpejta, të karakterit lokal, sidomos në lumenjtë me karakter të rrëkeve, të cilat zbresin prej viseve malore, ku si pasojë do të ketë tejkalim të kapaciteteve transportuese të tyre dhe mundësi të paraqitjes së vështirësive në sistemet e kanalizimeve, shembje të dheut, probleme në komunikacion, bujqësi etj.

Nga këto prognoza fillimisht meteorologjike me reshje e pastaj hidrologjike me mundësi vërshime në interval afatshkurtër nga shiu, parashihet që të kenë ndikim sidomos në:

- Pjesa veriore: Pellgu i Ibrit (Sistemet lumore të: Ibrit, Sitnicës Llapit, Drenica etj.) ku Probabiliteti për të tejkaluar një prag të periudhës së kthimit të përmbytjeve 20-vjeçare: është 20 % ndërsa 5-vjeçare: 24 %.
- Ndërsa pjesa Perëndimore, jugore dhe lindore (Pellgu i Drinit të Bardhë, Lepencit dhe Moravës së Binçës), parashikohet një probabiliteti për të tejkaluar një prag të periudhës së kthimit të përmbytjeve 5-vjeçare, gjegjësisht sasi më e vogël e reshjeve.

Sqarim: Krijimi i këtij informacioni të jashtëzakonshëm hidrometeorologjik, bazohet në produktet profesionale të çertifikuara prognostike të Qendrës Evropiane për Parashikimin e Motit ECMËF, ICON – KS, Shërbimi kombëtar gjerman i motit DWD, Sistemi Evropian i Parashikimit të motit Copernicus (EFAS), Modeli për parashikimin e përmbytjeve PANTA RHEI dhe të dhënat nga rrjeti shtetërorë i Stacioneve meteorologjike dhe Hidrologjike.

Përgaditi:

Dr. Bashkim Kastrati – Hidrolog
Sektori i Hidrologjisës (IHMK)



Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
Rruga "Lidhja e Pejës. Nr. 47
10000. Prishtinë

Tel: +383 38 603 179
<http://ihmk-rks.net/>
ihmk@rks-gov.net

Sektori i Hidrologjisës
bashkim.kastrati@rks-gov.net
Mob: +383 44 25 65 52